

Emri i Lëndës : Historia e Shtetit dhe së Drejtës							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 102	N/A	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Ilirjana Kaceli, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		Njohuritë mbi origjinën e institucioneve dhe mbi zanafillën e së drejtës janë parë të domosdoshme nga studiuesit e së drejtës. Historia e Shtetit, së drejtës dhe institucioneve juridike në Shqipëri analizon institucionet e së drejtës dhe shtetit shqiptar ndër shekuj. Objektivi kryesor i lëndës është të japë një panoramë të qartë të zhvillimit the institucioneve në planin kohor dhe për këtë arsye studion shtetin, të drejtën si dhe strukturat e shtetit në një shtrirje të gjatë kohore. Për të patur një kontekst më të gjerë, lënda do të trajtojë në mënyrë specifike pozicionin e Shqipërisë përse i përket organizimit institucional dhe juridik gjatë periudhave të ndryshme. Me anë të këtij kursi, studentët do jenë të aftë të kuptojnë rëndësinë e zhvillimit gradual të institucioneve dhe të së drejtës në tërësi.					
Objektivat		Ky kurs synon: 1. Të formojë pikëpamje bazë për shtetin dhe të drejtën në Shqipëri dhe raportet midis tyre. 2. Të kuptojë konceptin e procesit të zhvillimit të së drejtës në historinë e së drejtës dhe shtetit shqiptar. 3. Të interpretojë lidhjet shkak-pasojë të proceseve, dukurive dhe ngjarjeve të zhvilluara gjatë përpjekjeve të formimit të shtetit shqiptar. 4. T'i aftësojë studentët në arsyetimin dhe argumentimin e fakteve të ndryshme historike dhe sociale në kontekstin ligjor. 5. Të zhvillojë tek studentët mendimin kritik për tema që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të institucioneve aktuale në Shqipëri.					
Konceptet Kryesore		Shteti Ilir 2. Organizimi shtetëror 3. E drejta ilire 4. Shteti dhe e drejta në Epir 5. Organizimi shoqëror parashtetëror dhe lindja e shtetit në Epir 6. Organizimi shtetëror 7. E drejta në Epir 8. Pashallëku i Shkodrës dhe Janinës 9. Lidhja e Prizrenit 10. Qeveria e Ismail Qemalit 11. Mbretëria Shqiptare nën Princ Vidin 12. Kuvendi i Lushnjes 13. Shteti dhe e drejta gjatë regjimit të Ahmet Zog					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		KShteti dhe e Drejta në shoqërinë Skllavopronare në Iliri dhe Epir Ky leksion do të fokusohet në 3 çështje. Çështja e parë do të trajtojë shtetin dhe të drejtën në Iliri. Do të diskutohet rreth lindjes dhe zhvillimit historik në shtetin Ilir, organizimi shoqëror dhe shtetëror dhe e drejta ilire. Në çështjen e dyte, leksioni do të fokusohet në shteti dhe e drejta në Epir. Studentët do të njihen me organizimi shoqëror parashtetëror dhe lindja e shtetit në Epir; organizimi shtetëror dhe e drejta në Epir. Çështja e tretë do të trajtojë mbretërinë dardane e cila to të fokusohet në karakteristikat e zhvillimit të përgjithshëm shtetëror e juridik. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 11-50.					
2		Institucionet politike dhe juridike ne tokat shqiptare gjate shekujve V-XII Ky leksion do të trajtojë institucionet politike dhe juridike në tokat shqiptare gjatë shekujve V-XII. Leksioni do të fokusohet në: i) organizimi ekonomik e shoqëror në tokat shqiptare gjatë shek. V – XII; ii) tokat shqiptare në kohët e para të sundimit bizantin; iii) lufta politike në tokat shqiptare gjatë shek. V-VII; iv) përmbytja e skllavërisë dhe v) organizimi ekonomik e shoqëror i sistemit të bashkësive të lira (shek. VII-VIII). Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 51-61					

3	Organizimi ekonomik e shoqëror në periudhën e feudalizmit të hershëm (shek. IX-XII) Ky leksion do të trajtojë organizimin ekonomik dhe shoqëror në periudhën e feudalizmit të hershëm (shek. IX-XII). Pas prezantimit të organizimit ekonomik dhe shoqëror, leksioni do të fokusohet në sistemin administrativ bizantin në tokat shqiptare dhe të drejtën bizantine në tokat shqiptare në shek. IX-XII. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 62-71
4	Principatat feudale shqiptare të shekullit XII-XV Shekulli XII shënoi principatën e parë shqiptare, Principata e Arbërit, por është në shekullin e XIV dhe në fillim të shekullit XV periudha kur kjo principatë u bë më e fortë, sidomos për shkak të rënies së Perandorisë serbe. Në këtë leksion do të trajtohen principatat feudale shqiptare të shekullit XIX. Një rëndësi do ti jepet organizimit ekonomik – shoqëror dhe shtetëror në principatat feudale shqiptare. Leksioni do të trajtojë edhe të drejtën në principatat feudale shqiptare. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 72-105
5	Qytetet shqiptare në Mesjetë dhe organizimi i tyre politik Gjatë shek. XIV qytetet e Shqipërisë arritën në kulmin e zhvillimit të tyre që njohën gjatë mesjetës. Në krye të tyre qëndronte gjithnjë Durrësi, i cili kishte rreth 25 mijë banorë, dhe ishte një nga qytetet e mëdha të këtij shekulli. Ky zhvillim erdhi si pasojë e rritjes së ekonomisë së tyre, kryesisht e zhvillimit të zejtarisë. Ky leksion do të trajtojë organizimin dhe administrimin e qyteteve shqiptare në mesjetë dhe komunat qytetare autonome. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 106-128
6	Shteti i pavarur shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut Kryengritja fitimtare e nëntorit të vitit 1443 dhe Kuvendi i fisnikëve shqiptarë i mbajtur në mars të vitit 1444 në Lezhë, sollën ndryshime rrënjësore në organizimin administrativ, politik e ushtarak të viseve të çliruara shqiptare. Kuvendi i Lezhës realizoi të parin bashkim të gjerë politik e ushtarak të vendit në formën e një aleance ndërmjet përfaqësuesve kryesorë të aristokracisë shqiptare. Organi më i lartë qendror i këtij bashkimi u bë Kuvendi i fisnikëve. Organe të përhershme të Besëlidhjes ishin kryetari i saj, ushtria dhe arka e përbashkët, në krye të cilave u caktua një njeri i vetëm, Skënderbeu. Ky leksion do të trajtojë: i) krijimin e shtetit të përqëndruar shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut; ii) organizimin politik në shtetin e Skënderbeut; shteti i Skënderbeut në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe e drejta në shtetin e Skënderbeut. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 129-190
7	Institucionet Osmane Gjatë zhvillimit të këtij leksioni do të trajtohen çështjet kryesore që lidhen me vendosjen e sundimit osman në tokat shqiptare, tiparet e sistemit të ri politik dhe ekonomik, si dhe ndryshimet në jetën shoqërore, kulturore dhe fetare. Në fokus të vështrimit do të jenë gjithashtu përpjekjet e shqiptarëve për çlirim nga sundimi osman, lufta çlirimtare e udhëhequr nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe rezultatet e saj, si dhe kryengritjet e zhvilluara gjatë shek. XIX. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve politiko-shoqërore gjatë periudhës në fjalë, shthurjes së sistemit të timarit dhe lindjes së pronës çifligare, prirjeve të parisë shqiptare të kohës për emancipim politik, rolin dhe rëndësisë së pashallëqeve në jetën politike shqiptare, etj. Nëpërmjet zhvillimit të këtij kursi do të synohet që studentët të fitojnë njohuri të qëndrueshme në lidhje me aspektet themelore të një segmenti të rëndësishëm të historisë shqiptare të periudhës osmane, si dhe të aftësohen për të analizuar e interpretuar drejt e saktë ngjarjet, dukuritë dhe proceset që zhvillohen në periudhën e dhënë. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 191-210
8	Provim Gjysmëfinal

9	Pashallëqet Feudale Shqiptare Gjatë zhvillimit të këtij leksioni do të trajtohen pashallëqet feudale shqiptare duke u fokusuar tek pashallëku i Shkodrës dhe Pashallëku i Janinës. Pashallëku i Shkodrës (1757-1831) ishte një pashallëk gjysëm i pavarur nën Perandorinë Osmane, i lindur nga familja shqiptare e Bushatllinjëve. Territori fillestar i pashallëkut u shtrinte rreth Shkodrës dhe rrethinës së saj, në territorin e sotëm të Shqipërisë veriore dhe të Zi juglindor. Nën sundimin e Mahmud Pashë Bushatlliut arriti kulmin dhe në këtë kohë pjesë e pashallëkut ishte një pjesë e madhe e Shqipërisë, e Kosovës, pjesa perëndimore e Maqedonisë dhe pjesa juglindore e Malit të Zi. Mehmet pashë Plaku themeluesi i Pashallëkut të Shkodrës. Si rezultat i zhvillimit ekonomik, familje të mëdha feudale filluan të fuqizoheshin edhe politikisht e të shkëputeshin nga shteti osman. Ndërsa, Pashallëku i Janinës lidhet ngushtë me emrin e Ali Pashë Tepelenës. Ky lindi në vitin 1740 në një familje feudale ushtarake. Shumë shpejt u dallua për aftësinë, energjinë dhe zgjuarsinë e tij. Këto i vuri në shërbim të planeve të tij ambicioze, duke përdorur të gjitha mjetet : dhunën, dinakërinë dhe lidhjet familjare me feudalët e tjerë vendas. Në vitin 1784 Aliu mori gradën pashës dhe komandant ushtarak pranë valit të Rumelisë. Po këtë vit siguroi qeverisjen e sanxhakut të Delvinës, kurse më vonë u bë komandant i grykave (Derven) e qeveritar i sanxhakut të Triallës (Greqi). Me përkrahjen e borgjezisë zejtarë-tregtare të Janinës, vuri dore mbi sanxhakun me të njëjtin emër (1787) Porta e lartë (perandoria osmane) ishte e zënë në luftë me Austrinë prandaj e njohu Aliun si sundimtar të ligjshëm. Vëmendje të vecantë do ti kushtohet lindjes dhe zhvillimit të këtyre dy pashallëqeve; organizimit politik dhe të drejtës së zhvilluar. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 211-228
10	E Drejta Zakonore shqiptare E drejta zakonore shqiptare përfshin tërësinë e normave të pashkruara, të transmetuara deri më sot brez pas brezi, që kanë rregulluar marrëdhëniet shoqërore në një varg krahinash të Shqipërisë. Është dukuri historiko-shoqërore që ka vepruar për shekuj me radhë kryesisht në krahinat malore të vendit. Ruajtja e së drejtës zakonore për një kohë të gjatë e përballimi i presioneve të së drejtës së shteteve pushtuese, janë shprehje e qëndresës së popullit shqiptar për të mbrojtur qënien, gjuhën dhe kulturën e tij. Në të drejtën zakonore shqiptare gjenin pasqyrim disa nga tiparet themelore të psikologjisë shoqërore të vendit tonë, si: nderi, besa, burrëria, mikpritja etj. Ky leksion do të fokusohet në i) kuptimin e së drejtës zakonore shqiptare; ii) burimet dhe parimet e saj kryesore; iii) marrëdhëniet familjare; iv) marrëdhëniet e pronësisë dhe detyrimet; v) e drejta zakonore penale dhe vi) procesi gjyqësor. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 229-287
11	Lidhja shqiptare e Prizrenit Një rol të rëndësishëm në formësimin e vetëdijes kombëtare është lidhja shqiptare e Prizrenit. Lidhja e Prizrenit ishte një organizim politik i parisë së katër vilajeteve shqiptare në Perandorinë Osmane, themeluar zyrtarisht më 10 qershor 1878 në xhaminë Bajraklië të Prizrenit, ku deri një vit përpara ishte qendra e Vilajetit të Kosovës. Në mbledhjen e parisë më 18 qershor u radhitën qëndrimet e mbajtura në një shkresë të vendimeve quajtur Kararnamë, që u firmos nga 47 përfaqësues të kazave të vilajetit, ku në krye janë firmat e Iljaz pashë Dibrës dhe Abdullah pashë Drenit. Një vëmendje të vecantë do ti kushtohet Kararnamë dhe organizimi gjyqësor në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 288-303
12	Shteti i Pavarur shqiptarë në vitet 1912-1914 Në vitet 1912-1914 shqiptarët për herë të parë nisën procesin e krijimit të shtetit kombëtar. Ky proces rezultoi tejet i vështirë për shkak se përgatitja kulturore politike e kombit shqiptar ende nuk kishte arritur nivelin e duhur për tu përballur me shtetformimin dhe ngaqë faktorët e jashtëm pengues dhe shpërbërës rezultuan shumë të fuqishëm. Qeveria e Përkohshme e Vlorës që u krijua pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912 bëri përpjekje dhe arriti disa suksese në ndërtimin e institucioneve kombëtare dhe në fillimin e procesit të deosmanizimit. Por ajo u godit rëndë nga refuzimi i Fuqive të Mëdha për ta njohur si dhe nga përballja me forca opozitare partikulariste të brendshme, ku më e spikatura prej tyre ishte Pleqësia e Shqipërisë së Mesme e kryesuar nga Esat Pashë Toptani. Leksioni do të trajtojë rrethanat që çuan drejt shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të qeverisë së Vlorës. Një vëmendje të vecantë do ti kushtohet problemet të shtetit shqiptar në politikën e fuqive të mëdha dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Gjithashtu, leksioni do të trajtojë shtetin shqiptar nën Vidin dhe Statuti Organik i Shqipërisë. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 304-328 13

13	Rimëkëmbja e Shtetit kombëtare shqiptar dhe përpjekjet për demokratizimin e tij në vitet 1920-1924 Vitet 1920-1924 kanë një rëndësi të madhe për rimëkëmbjen e shtetit kombëtar shqiptar. Gjatë kësaj periudhe kemi përpjekjet e para për demokratizimin. Leksioni do të trajtojë Kongresin e Lushnjës dhe vendimet për rimëkëmbjen e shtetit kombëtar shqiptar. Një vëmendje të vecantë do ti kushtohet analizës juridike të “Statuti i Lushnjës” dhe “Statutit të Zgjeruar të Lushnjës”. Një ngjarje tjetër gjatë kësaj periudhe është Revolucioni i Qershorit 1924 dhe Qeveria e F. S. Nolit. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 329-358
14	Shteti dhe e drejta gjatë regjimit të Ahmet Zogut Me përmbyshjen e qeverisë së Nolit, në pushtet erdhi Ahmet Zogu. Më 25 janar 1925, Kuvendi Kushtetues shpalli Republikën Shqiptare. Dhjetë ditë më vonë, Ahmet Zogu u zgjodh kryetar i republikës, duke qenë në të njëjtën kohë edhe kreu i pushtetit ekzekutiv. Gjatë kësaj kohe, Ahmet Zogu riktheu stabilitetin në vend, si dhe mundësoi nënshkrimin e marrëveshjeve të rëndësishme ekonomike, politike e ushtarake që forcuan pozitën e Shqipërisë. Leksioni do të trajtojë organizimi shtetëror në republikën e vitit 1925-1928 dhe në periudhën e monarkisë në vitet 1928-1939. Një vëmendje të vecantë do ti kushtohet zhvillimit të së drejtës në këtë periudhë. Literatura përkatëse: 1. Luan Omari dhe Aleks Luarasi (eds), Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri (botimi 4rt, University Press Luarasi 2005) 359-406. 2. Arsim Bajrami, Historia e Konstitucionalizmit Shqiptar 1912-2012 (Akademia e Shkencës dhe Arteve e Kosovës 2014) 71-84.
15	Shqipëria në sistemin socialist totalitar dhe tranzicioni drejt pluralizmit politik Ky leksion do të trajtojë karakteristikat kryesore të së drejtës në sistemin socialist totalitar. Enver Hoxha (16 tetor 1908 - 11 prill 1985) ishte udhëheqësi komunist i Shqipërisë nga viti 1944 deri në vdekjen e tij në vitin 1985, si Sekretar i Parë i Partisë së Punës së Shqipërisë. Ai ishte kryetar i Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura nga viti 1944 deri në vdekjen e tij. Ai shërbeu si Kryeministër i Shqipërisë, 1944-1954 dhe në kohë të ndryshme ka shërbyer si ministër i jashtëm dhe si ministër i mbrojtjes. Periudha 40 vjeçare e sundimit të tij, u karakterizua nga eliminimi i opozitës, dënimet e kundërshtarëve të tij politikë me vdekje ose burgime të gjata dhe dëbimet e familjeve të tyre nga shtëpitë ku jetonin dhe internimet e tyre në fshatra të thella, ku kontrolloheshin rreptësisht nga policia dhe Sigurimi i Shtetit (policia sekrete). Gjithashtu, diktatura komuniste, u karakterizua nga metodat staliniste të asgjësimit të bashkëpunëtorëve të tij, që kërcënonin pushtetin e tij personal. Një vëmendje të vecantë do ti kushtohet tranzicioni drejt pluralizmit politik duke u fokusuar në i) shkaqet që çuan drejt rënies së sistemit totalitar socialist; ii) aktorët kryesorë në periudhën tranzitore dhe iii) zhvillimin e sistemit ligjor bazuar në konventat ndërkombëtare dhe standartet europiane. Literatura përkatëse: 1. Arsim Bajrami, Historia e Konstitucionalizmit Shqiptar 1912-2012 (Akademia e Shkencës dhe Arteve e Kosovës 2014) 85-148.
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• 1. Aleks Luarasi, Historia e shtetit dhe e se drejtes ne Shqiperi (Maluka, 2018) • 2. Arsim Bajrami, Historia e Konstitucionalizmit Shqiptar 1912-2012 (Akademia e Shkences dhe Arteve e Kosovës 2014)
Referenca të tjera	• 1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar: Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë Shek. XVI-vitet 20 të Shek. XIX vol I (Botimet Toena 2002) • 2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar: Rilindja Kombëtare vol II (Botimet Toena 2002) • 3. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar: Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912-7 Pril 1939 (Botimet Toena 2002) • 4. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar: Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990 (Botimet Toena 2002)
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë evolucionin e institucioneve nga koha e lashtë në kohën moderne.
2	Studentët do të kenë njohuri të mirëfillta në zanafillën e krijimit të shtetit dhe së drejtës në Shqipëri
3	Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë dallimin mes formave të shtetit në periudha të ndryshme duke filluar nga antikiteti e deri në kohën moderne
4	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë ndryshimet në mënyrën e zhvillimit të institucioneve.
5	Studentët do të jenë të aftë të njohin më mire organizimin aktual shtetëror në Shqipëri duke qenë se do kenë informacione të detajuara për periudhat e mëparshme.
6	Studentët do të jenë të gatshëm për t'u bërë pjesë e diskutimeve të frytshme në fushën e kulturës së përgjithshme mbi historikun e institucioneve dhe së drejtës në Shqipëri.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	10	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	11	11
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00